



Nr. 4 Prot.

Dt.26.03.2016

Objekti: Hapja e procesit të regjistrimit të kandidatëve për autoritetet dhe organet drejtuese në FAB

VENDIM

Bazuar në ligjin Nr.8485, dt. 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenit 131 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 110, dt. 15.03.2016 dhe Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në insitucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

Komisioni i Zgjedhjeve në Fakultet vendosi hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për autoritetet dhe organet drejtuese në FAB, Përgjegjës të Njësive Kryesore dhe Përgjegjës të Njësive Bazë.

Të gjithë të interesuarit për t'u vetëkandiduar për Dekan dhe Përgjegjës të Njësive Bazë duhet të plotësojnë formularin e vetëkandidimit për këtë pozicion.

Formulari i vetë kandidimit tërhiqet pranë zyrës së KZF.

Dorëzimi i aplikimit bëhet pranë KZF.

Afati i fundit i pranimit të aplikimeve është Ditën e enjte dt.31.03.2016, ora 16.00.



Anëtar: Ilir Kaso

Anëtar: Valbona Karanxha

Kryetar

Viktor Ferrar

Anëtar: Arben Bajo

Anëtar: Françesko Dine

SEKRETAR

Ermon Hoxha

